

HO ME+

Vizatime nga / Drawings by Muslim Mulliqi

HOME +

Vizatime nga / Drawings by Muslim Mulliqi

Kuruar nga / Curated by Zeni Ballazhi

HOME +

Vizatime nga Muslim Mulliqi / Drawings by Muslim Mulliqi

Kuruar nga / Curated by:
Zeni Ballazhi

Dizajni i ekspozitës / Exhibition design:
Mjellma Goranji-Firzi

Katalogu / Catalogue

Katalogu i ekspozitës publikohet nga ana e Galerisë Kombëtare të Kosovës, Agim Ramadani, 360, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

30 Maj – 30 Qershor 2019

The catalog of the exhibition is published on behalf of National Gallery of Kosovo, Agim Ramadani, 360, 10000 Prishtina, Republic of Kosovo

Botues / Publisher
Galeria Kombëtare e Kosovës / National Gallery of Kosovo

Përkthimi / Translation:
Ardian Haxhiu

4

Autor kontribues / Contributing author
Zeni Ballazhi, Rexhep Ferri

Lektorimi / Proofreading:
Jehona Xhaferi

Dizajni / Design
Trembelat

Shtypi / Print
Viprint

Të gjitha veprat © dhe konsiderata e artistit / All artworks © and courtesy the artist, unless otherwise stated

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij libri nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në sisteme ripërdorimi e as të transmetohet në asnjë formë ose mënyrë, elektronike, mekanike, fotokopje, të incizuar, e tjera, pa lejen paraprake të botuesit.

All rights reserved. No part of this book may be reproduced, stored in a retrieval system or transmitted in any form or by any means, electronic, mechanical, photocopying, recording or otherwise without prior permission of the publisher.

Viti / Year 2019

Katalogimi në botim – (CIP) – ISBN
Biblioteka Kombëtare e Kosovës
“Pjetër Bogdani”



Ekspozita dhe katalogu janë realizuar me mbështetje nga Ministria e Kulturës, Rinisë Dhe Sporteve

The exhibition and catalogue are supported by The Ministry Of Culture, Youth And Sports



Sponzor medial / Media sponsor



Stafi i Galerisë Kombëtare të Kosovës
National Gallery of Kosovo staff
Arta Agani, drejtoreshë - director; Zeni Ballazhi, kurator - curator; Mexhide Maxhuni, zyrtare për financa - financial officer; Lirije Buliqi, zyrtare e lartë administrative - senior administrative officer; Naim Spahiu, kordinator për ekspozita - coordinator for exhibitions; Enver Bylykbashi, fotograf profesional - professional photographer; Skender Xhukolli, teknik për ekspozita - exhibition technician; Rahman Bislimi, teknik për ekspozita / mirëmbajtës i objektit - exhibition technician / building caretaker; Xhevat Rrahimi, kujdestar i sallës ekspozuese - exhibition hall attendant; Valdet Sylja & Mentor Abdullahu, roje nate - security guards



HOME +

“HOME +” vizatime me emrin e doajenit dhe piktorit të parë akademik Muslim Mulliqi, i cili me krijimtarinë e tij pamore la gjurmë të pashlyeshme në artin pamor shqiptar.

“Për këtë qëllim, përparimet e termave kanë dy forma: “Rezultati i propozimeve - Veprimi” - rezultati ka përparësi, dhe tjetra (për të prodhuar rezultatin) ka përparësi veprimi. Kur veprimi ka përparësi, ne përpiqemi ta kuptojmë pamjen në drejtim të veprimit që e prodhon atë. Në këtë rast rezultati dhe veprimi kanë prioritet.

Veprat e Muslim Mulliqit japin shumë mesazhe të lidhura me kohën dhe botën e tij.

Vizatimet si baza themelore e shprehjes pamore, kompozicionet (duke kërkuar hapësira të reja) janë evidente. Kjo na bën që të zbulojmë dhe ta kuptojmë lidhjen me veprën, lirinë e interpretimit të tij në raport me realitetin e një jete të jetuar në mënyrën tonë të lirë.

Këto vizatime shërbejnë si një lidhje organike ndërmjet këtyre pozicioneve, në të cilat përdoren dimensionet e mëdha të qytetit dhe pejsazhit.

Vizatimi është një analizë gramatikore, kompozim dhe në të njëjtën kohë shpërbërje e atyre mjeteve që i janë besuar historikisht artistit për të manifestuar veten.

Hapësira publike si shfrytëzim kohor i ambientit ku ndërtohet një mbështjellje hapësinore ndjek harmoninë, përpjesëtimin dhe simetrinë, si dhe përmasat që janë të banueshme në mënyrë metafizike jo nga njeriu, por nga hija e tij.

Moment konstruktiv është realizimi arkitektonik i hapësirës në të cilën ndjesia dhe pasqyrimi bashkëpunojnë për të krijuar një ndërgjegje hapësinore-kohore të pashpallur, e cila nuk është abstrakte por e drejtpërdrejtë dhe konkrete, sipas një dinamike të ekuilibruar të sasisë me cilësinë, fizikes me psikikën, gjë që është më e afërt me modelet e kulturës orientale.

Në vizatimet e Mulliqit zënë vend edhe referencat mitologjike, simbolike dhe rishfaqen gjithmonë brenda zhvillimit të tyre koherent drejt një ekspresioni figurativ dhe origjinal.

Ai mbështetet në forma të marra nga bota reale, nga të cilat ekzistojnë shembuj të pafund.

Arti jeton në konkretësinë e tij, në mjetet që përdoren për ta realizuar, ku përmirësimet konsistojnë në mundësinë e një përdorimi më të thellë e të një shtrirje më të gjerë, të një ngjarjeje që mbetet e përditshme, ndërsa aftësia krijuese konsiderohet si veprimtari e veçantë. Veçantia bëhet kështu elementi lidhës dhe përshtatës me shoqërinë: Arti gjen shfaqjen e tij esenciale në veprimtarinë e tij konkrete.

Veprimet e kësaj ndërhyrjeje në hapësirën e galerisë mbeten të ankoruara në vlerën e improvizimit që dëshiron t'i kundërvihet të jetuarit sistematik dhe të standardizuar të një rreze të lirisë së menjëhershme.

Zeni Ballazhi, kurator

“HOME +” drawings by the doyen and the first academic painter, Muslim Mulliqi, who with his visual creativity left unforgettable traces in Albanian visual art.

Because of this, the advanced themes have two forms:” Outcome of Proposals - Action “- the result has priority and the second (to produce the result) action has the priority. When action has priority, we try to understand what we see toward the action that produces it. In our case the result and the action have priority.

Muslim Mulliqi’s works give many messages that are related to his time and his world. Drawings, as the basis of visual expression, compositions (while seeking new spaces) are evident. This makes us discover and understand freely, in our own way, the connection to the work, the freedom to interpret it in relation to the reality of a life that’s been lived. These drawings serve as an organic link between these positions, in which the great dimensions of the city and landscapes are used. Drawing is a grammatical analysis, composition, and at the same time dissolution of those tools, historically entrusted to the artist to express himself.

Public space as a time utilization of the environment where a space wrap is built follows harmony, proportion and symmetry, dimensions that are metaphysically inhabitable not by the human but by his shadow.

A constructive moment is the architectural realization of the space in which sensation and reflection co-operate with each other to create a space-time conscience, which is not abstract but direct and positive,

according to a balanced dynamic of quantity and quality, physics with psychics, which is closer to the oriental culture patterns.

Mulliqli's drawings also include mythological, symbolic references and always reappear within their coherent development towards a figurative and original expression. It relies on shapes obtained from the real world, of which there are endless examples. Art lives in its reality, in the means that were used to accomplish it, where improvements consist in the possibility of deeper use and of a wider extension of an event that remains a daily routine, while creative ability is considered as a separate activity. His uniqueness becomes the connecting and adaptable element with the society: Art becomes its essential appearance in his activity.

The actions of this intervention in the gallery area remain anchored in the value of improvisation that wants to resist systematic and standardized living of immediate freedom.

Zeni Ballazhi, curator





Portreti i Muslim Mulliqit
Portrait of Muslim Mulliqi

1.

Më 13 janar 1998, në orët e para të mëngjesit, Visari, i biri i Muslim Mulliqit, më telefonoi për ta ndarë pikëllimin me dikë tjetër të afërt:

- Profesor, baba vdiq!

Në fillim nuk besova.

Nuk isha i përgatitur që të besoj.

Me një shqetësim të dhimbshëm shpejt u nisa dhe shkova.

Muslimin e gjeta të shtrirë aty ku zakonisht rrinte ulur. Aty edhe atë ditë e kishte pritur kafënë e mëngjesit.

Vetëm dy apo tri ditë më parë, në kafe-galerinë "Koha" pasi e çuam nga një gotë, Muslimi më foli për monografinë e vet.

Ishte i dëshpëruar se si shtyhej, se si vonohej botimi i saj.

Rrjedhat për artin tonë na kthenin në ditët e shkuara.

Por vdekja kishte qenë më e shpejtë.

Vdekja që askënd nuk e la pa e prekur.

2.

Për ta kuptuar poemën e mjerimit të Migjenit.

Imazhet e fotografive të Kel Marubit. Dhe botën e poezisë së Esat Mekulit: "O vlla me sharr në krah". Jo shumë larg Hamallit të dënuar me vuajtje, Muslim Mulliqi shpejt i kaloi kthesat dhe doli te fryma krijuese e ekspresionizmit. Vetëm dy sekonda të nevojiten për ta kuptuar e njohur vulën e personalitetit të tij krijues.

Si t'i kishte katër duar, në pikturë i erdhi jeta e "Hamallit" që dilte për t'u shitur në pazar, sa për të blerë bukë, krip e gaz.

3.

Në kërkim të diçkaje të njohur e të panjohur për ta shënuar kohën e fateve të humbura dhe për të harruar diçka, e për të parë një ëndërr edhe tani e kam të afërt kujtimin dhe qëndrimin krenar të ecjes së Muslimit.

Hapat i kishte me një ritëm të matur, të qetë.

Pak të ngadalte e fitues.

Kjo e ecur, me karakteristikë të rrallë, ia shtonte sharmin figurës së tij. Me qetësinë e heshtjes fisnike mbeti e pranishme për t'u parë se ka qenë piktor i mirë dhe mik i mirë.

Më është dashur kohë që të bindem se ka vdekur.

Është njerëzore të pranoj se gjatë do ta ndiej mungesën e tij.

Në mesin tonë ishim mësuar ta kishim me energjinë e tij të pashtershme.

Në kohën kur më së shumti pritej prej tij të krijonte vepra të reja, peizazhe, kulla, portrete, papritmas Muslimin e thirri vdekja. Vazhdimi i një realiteti të pashmangshëm.

4.

Muslim Mulliqi ishte piktori më me ndikim nga të gjithë ne që e filluam jetën e arteve figurative në Kosovë. Për nga natyra ka qenë i lindur si shpirt artisti. Atëherë, pak kush si ai, ka ditur ta shprehë vetveten si krijues. Ashtu e ka jetuar edhe jetën. Nga ajo kohë ne sot e kemi realitetin historik të atyre viteve të ruajtur në pikturë si përjetim, si kohë, si krijimtari që nuk përsëritet. Nga ato vlera të krijuara nga Muslim Mulliqi, ndikimi do të ndihet edhe në gjeneratat e ardhshme.

Pa veprën e Muslim Mulliqit nuk mund të paramendohet arti modern shqiptar.

50 vjet ishin në rrjedhat e ngjarjeve krijuese.

Klasik dhe modern.

Në shoqëri Muslimi kishte ndikim të madh. Paraqitja e tij e veçantë kishte shumë ide, shumë merita.

Personaliteti i tij ishte frymëzues.

Për krenarinë tonë një copë Evropë.

5.

Për shumë gjëra, disa herë, nuk jemi pajtuar. Mes nesh mund të ketë pasur një fije zillie, por atëherë në Kosovë kanë ndodhur aq shumë gjëra sa që e kishim harruar se ç'është xhelozia profesionale. Koha që kalonte na ruante drejtpeshimin. Nuk e di si ta them më qartë.

Nga mesdita e nga mesnata jam afruar të shoh. Një pikturë e Muslim Mulliqit më vjen e më frymëzon.

Kullat e Malësisë së Gjakovës dhe të Dukagjinit Muslimi së pari i paraqiti si realizëm.

Pastaj si histori.

Dhe, në fund si legjenda.

Një ditë i thashë:

- Muslim, një kullë që pikturove ti unë e pashë mbi një barkë e mbi një det. Pavarësisht nga vitet, diku shkonte.

Ai shumë shpejt e kapi imazhin e figurës në kornizë.

Udhëtimi im poetik gjithmonë i pëlqente.

Edhe pse ishim të afërt, ishim edhe të ndryshëm.

Ndryshueshmërinë gjithmonë e kemi respektuar si vlerë.

Muslimi ishte mik i afërt edhe me Anton Pashkun.

Për kullat e Muslimit më ka folur disa herë Antoni.

Kur ishim vetëm me artin, Muslimi dukej më i afërt edhe më i kapshëm. Shpejt i kuptonte frytet e krijimtarisë dhe i përshtatej kohës.

6.

Nevojitet shumë kohë për ta kuptuar si e ka jetuar jetën brenda këtyre sfidave. A i ka realizuar ëndrrat e veta, kjo pyetje e ka një pse. Kurrkujt ndoshta nuk i realizohen të gjitha kërkesat...

Si në të gjitha historitë, Muslim Mulliqi pikturën nuk e vazhdonte aty ku e kishte lënë. Më larg se larg parashikonte një ecje.

Atje ku jeta ndahet në dy pushime. Muslim Mulliqin e thërriste Muslim Mulliqi.

Përtej kuptimit të peizazhit ekspresionist, me sytë e një vizatimit të Pikasos, Kokoshkës, Munkut, Sutinit, Stupicës unë në pikturat e Muslimit pashë Parisin, Barcelonën, Madridin edhe pse kurrë s'kam qenë as në Barcelonë e as në Madrid.

7.

Muslimi një ditë më tha:

- Rexhep, e lexova shkrimin që Anton Pashku e ka shkruar për ty.

Unë qesha. Më erdhi mirë. Muslimi ndezi një cigare dhe vazhdoi:

- Antoni më tha se është duke shkruar për krijimtarinë time. Titullin ma tha: "Lahuta e re e malësisë".

Pas një jave në një gazetë ditore lexova shkrimin e Antonit që e kishte shkruar për krijimtarinë e Muslim Mulliqit. Tani s'mund të ndahem pa e treguar si fillon ai shkrim: "Muslim Mulliqi, krijuesi ynë, në të vërtetë, është një fetar i madh, më falni. Është një besimtar i devotshëm i artit. Është njeri që vazhdimisht përkulet para Bukurisë. E bukura për të është shenjtëreshë".

Për Muslimin Anton Pashku shkruan: "Po më kujtohet edhe një maestro, gjithashtu i madh, që quhet Gjergj Fishta. Po më kujtohet Vrani-na, Oso Kuka, kulla në një qosh të Liqenit të Shkodrës"... Brenda kështjellës së kohës së vet, Muslim Mulliqi nga ajo kohë nxori dhe vendosi një kohë tjetër, në kohë dhe hapësirë të sotme... Oso Kuka të rinj Tringa e Tringesha të reja.

8.

Tani kullat e Muslim Mulliqit janë kulla që ua kalojnë të gjitha kullave të Malësisë së Gjakovës, e të kullave të Dukagjinit.

Të hapësirës si ajo mes numrave të matematika-tikës.

Për t'i kthyer idetë në realitet. Fama e numrave të matematikës nuk është rastësi.

Histori, jo legjendë.

Legjendë, jo histori.

Për të ecur me sukses.

Për një lajm të humbur, për një lajm të gjetur.

Muslim Mulliqi duke u nisur nga portretet për të dalë te kullat dhe nga kullat për të dalë te portretet, dashur e padashur portretet dhe kullat shumëçka i dhanë njëra-tjetrës. Këtë kod të vlerave krijuese Muslimi e kishte të qartë por kurrë nuk shkonte për të kërkuar diçka më larg

se njeriu. Historia e portreteve të mbretëreshës Teuta apo të zonjave me qafë të gjatë në stil. Me sy të zi të qartë, e me mrekullinë e të bardhës. Me flokë të krehura, të krehura e të krehura, si ta kishin pushtuar pranverën. Me bishtka, me tentene, me rruaza, me gjethe. Ato portrete atëherë dhe tani janë një paraqitje me sfida e salltanetet të nuseve të pasanikëve, të grave e zonjave të qytetit. Të njëfarë baroku ballkanik. Për shijen e Muslimit ndoshta s'kanë qenë as shkollë as farë baroku ballkanik, por një fisnikëri e lindur dhe e trashëguar, e pamundur që të harrohet.

9.

Muslim Mulliqi duke ecur në drejtim të duhur, në drejtim të njohur e të panjohur, filon të pikturojë diçka që është pak më larg se bota e tij krijuese. “Pushtimi i hapësirave të reja” e thërriste. Ai besonte edhe pa e ditur pse besonte. Më vonë u pa se edhe ajo thurje për krijimtarinë e Muslimit paska qenë punë fati. Ai, duke kërkuar diçka më shumë nga imagjinata, pikturoi ciklin e pikturave që i kishte ëndërruar ndoshta me vite. Gjatë viteve të fundit, Muslimi, i qetë, i shqetësuar, por i përmbajtur, çdo ditë thërriste me telefon. Kërkonte të dilte në qytet, me miq dhe shokë të pinte një kafe dhe të bisedonte e të kuptonte se çka është duke ndodhur me çudirat e pakuptueshme të viteve të fundit me botën shqiptare.

10.

Pak pa u ndarë nga jeta, Muslimi më foli për Gjakovën.

Malli e kishte marrë për vendlindjen.

Pasi dolëm nga kafe-galeria “Koha”, shikoi qiellin. Nata ishte me hënë.

Rexhep, më thirri dhe tha: “Gjakova dikur ka qenë si Shkodra. Çdokush dinte t'i binte një vegle muzikore dhe çdokush dinte të këndon-te. Atëherë në Gjakovë ka qenë i njohur Ahmet Pylla me violinë dhe mustaqoshi Ymer Riza me sharki”.

Dhe krejt në fund legjenda thotë:

Mbetet të presim.

Nga viti në vit të shohim.

Cila botë po na afrohet dhe cila botë do ta prezantojë të ardhmen.

Vetëdija dhe mendimi krijues studiohet, shprehet, lëvizë dhe shkon deri atje ku mund të shkojë njeriu.

Për hapësira të reja.

Të njohura e të panjohura.

Muslim Mulliqi për ta ruajtur të bukurën, pikturën nuk e lëmonte me ngjyrë. Me ngjyrë e ushqente.

Rexhep Ferri

1.

On 13th of January 1998, in the early hours of the morning, Visar, Muslim Mulliqi's son, gave me a call to share his grief with someone else close to him:

- Professor, my father died!

At first I didn't believe it.

I wasn't ready to believe it.

Worried painfully I quickly went there.

I found Muslim lying where he usually used to sit. Even on that day, he was waiting for his morning coffee.

Just a couple of days earlier, after we had a drink at the cafe-gallery "Koha", Muslim started talking about his monography.

He was desperate about the way his publication was being delayed.

The path of our art took us back to the past times.

But death was faster.

The death that left no one untouched.

2.

To understand the poem of 'Misery' by Migjeni.

The photo images by Kel Marubi. And the world of Esat Mekuli's poetry: "O brother with a saw in your arm". Not far from "Hamall"-(Load-er), condemned by suffering, Muslim Mulliqi quickly overtook these obstacles and found the creative spirit of Expressionism. You only need a couple of seconds to understand his creative personality.

It's as if he had four hands, in his painting appeared the life of "Hamall", who sold himself at a market, so he could buy bread, salt and gas.

3.

In search of something known that is unknown, to mark the time of lost fate, to forget something and to dream, I still have a fresh memory of his stoic attitude and the way he walked proudly.

His steps were moderately paced, calm.

Slightly slower and victorious.

His walk, with its rare characteristics, added to his charm. With a noble silence he showed us what a good painter and a good friend he was.

I took some time to convince myself that he was dead.

It is only human to admit that I will miss his absence for a long time.

We were used to his inexhaustible energy amongst us.

At a time when it was expected from him to create new works, landscapes, towers, portraits, suddenly death called Muslim. Continuing an inevitable reality.

4.

Muslim Mulliqi was the most influential painter of all of us that started figurative arts in Kosovo. By nature he had a soul of an artist. Not many knew how to express themselves as creatively as he did. That's the way he lived his life as well. From that time we have the historical reality of those years preserved in painting as an experience, as a time, as a composition that cannot be repeated. The values created by Muslim Mulliqi, and his influence will be felt by future generations as well.

Without Muslim Mulliqi's work, modern Albanian art cannot be imagined.

His works were for 50 years in the course of creative events.

Both classic and modern.

Muslim was great influence in our society. His unique presentation had many ideas, many merits.

His personality was inspirational.

A piece of Europe for our pride.

5.

Often, we wouldn't agree on many things. There may have been some envy between us, but then so much has happened in Kosovo that we have forgotten what professional jealousy is. The time that we passed kept our balance. I do not know how to put it more clearly.

From noon till midnight I came to see.
A Muslim Mulliqi's painting comes to me and
inspires me.

In the beginning the highland towers of
Gjakova and Dukagjini, Muslim introduced them
as realism.

Then as a history.

And in the end as legends.

One day I told to him:

- Muslim, I saw a painting of a tower that
you made on a boat and over a sea. Regardless
of its age, it was going somewhere.

He quickly got the image of the picture on
the frame.

He always liked my poetic journey.

Although we were close, we were also
quite different.

We have always respected variety as a
value.

Muslim was also a close friend of Anton
Pashku.

Anton talked to me about the Muslim's
towers several times.

When we were alone with art, Muslim
seemed closer and more accessible. He quickly
understood the creativity and adapted to the
times.

6.

A long time is needed to understand the
way he lived his life with all the challenges. His
dream had come true, but this question has a
why. No one will fulfill all his needs...

As in all histories, Muslim Mulliqi did not
continue his painting where he left it. Further
than far he anticipated a walk.

Where life is divided into two stops. Mus-
lim Mulliqi was called by Muslim Mulliqi.

Beyond the understanding of expres-
sionist landscape, with the eyes of a Picasso,
Kokoshka, Munk, Sutin, and Stupica in Muslim's
paintings I saw Paris, Barcelona and Madrid
although I have never been to Barcelona nor
Madrid.

7.

One day Muslim said to me:

- Rexhep, I read the writing that Anton
Pashku has written about you.

I smiled. It felt good. Muslim lit a cigarette
and continued:

- Anton told me that he is writing about
my work. He told me that the title was, "Lahuta e
re e malësisë."

The next week in a daily newspaper, I read
Anton's story that he wrote about the creativity
of Muslim Mulliqi. Now I have to tell how this
script begins: "Muslim Mulliqi, our painter, in
fact, is a great religious believer, sorry. He is a
great believer of art. He is a man who constantly
bows before Beauty. Beauty for him is a saint. "

About Muslim, Anton Pashku wrote: "I
also remember a great maestro that was called
Gjergj Fishta. I remember Vranina, Oso Kuka, a
tower in a corner of Shkodra Lake "... Inside the
castle of his time, Muslim Mulliqi pulled it out
and set it in another time, in today's time and
space ... New Oso Kuka and new Tringësha.

8.

Now, Muslim Mulliqi's towers surpass the
highland towers of Gjakova and Dukagjini.

Of space like those between math num-
bers.

To turn ideas into reality. The fame of math
numbers is no coincidence.

History, not legend.

Legend, not history.

To walk successfully.

For a lost news, for a news that is found.

Muslim Mulliqi started to move from
portraits to towers and from towers to go back
to portraits, whether he wanted or not, portraits
and towers gave so much to each other. This
code of creative values was clear to Muslim
but never went to seek something far from the
human. The story of portraits of Queen Teuta
or of long-necked stylish women. With clear
black eyes, and with the miracle of white. With
combed and combed hair, like they have in-

vaded the spring. With ponytails, with beads, and leaves. Those portraits then and now are a presentation with challenges and richness of bridesmaids of wealthy, of women and ladies of the city. Of some kind of Balkan Baroque. For Muslim`s taste perhaps they were neither school nor Baroque Balkan, but a noble birth that was inherited and impossible to forget.

9.

Muslim Mulliqi, while walking in the right direction, in familiar and unfamiliar directions, begins to paint something that is a bit further than his creative world. "The invasion of new spaces" was calling him. He believed even though he didn't know why he believed. Later we realized that the story about the creativity of Muslim's work was fate. While looking for something more than imagination he made the paintings that he had probably dreamed of for years. During the last few years Muslim, calm, restless but contained called me every day on the phone. He wanted to go out with friends to have a coffee and talk and understand what is happening with the incomprehensible wonders in recent years with the Albanian world.

10.

Just before he died Muslim talked about Gjakova.

He was missing his hometown.

After we left the cafe-gallery "Koha", he looked up in the sky. Night was clear and we could see the moon.

Rexhep, he called and said, "Gjakova was once like Shkodra. Everyone knew how to play a musical instrument and everyone knew how to sing. At that time in Gjakova there was the famous guy called Ahmet Pylla with violin and a men with mustache called Ymer Riza with shar-ki.(native musical instrument).

And finally in the end the legend says:

We have to wait.

From year to year we`ll see.

Which world is approaching and which world will present the future.

Consciousness and creative thinking is studied, expressed, moved and goes where one can go.

For new spaces.

Known and unknown.

Muslim Mulliqi, in order to preserve the beauty, didn't just brush the paint with color. But with color he fed it.

Rexhep Ferri






HO ME+

Vizatime nga / Drawings by Muslim Mulliqi
















































OBRAZLOŽENJE POJEDINIH STAVKI IZ IZVJEŠTAJA

Kao što se iz priloženog izvještaja vidi, Akademijska poslovala se ostetkom čistog dobitka...
Prema Zakonu o knjigovodstvu... je...
sajedničke potrebe...

Prihodi za 1981...
...u skupnoj iznosi...
...posmat, kao pojedinačne...
...to se konstatovati...
...svoje sredstva.

...usluge, jer su ti...
...veći...
...povećanju...
...pute...
...usluge...
...pre-
koračne može postići...
I ako nisu veliki, troškovi reprezentacije su premašili zakon-
sko ograničenje i veći su u odnosu na prošlu godinu za 23%.

Ova vrsta troškova trebala je biti manja za 20%, pa u buduću
treba povesti više računa i tačno precizirati ko i
koliko ima pravo na reprezentaciju.
to se više ostalih troškova koji su također ograničeni (putni
troškovi, dnevnice i dr), kretali su se u okviru zakonskih
propisa.

AKADEMIA E ARTEVE PRISHTINE

RR E G U L L O R E

MBI PUNEN E PLAZES AKADEMISE SE ARTEVE PRISHTINE


Prishtine, 1976
























































































Grafica — grafică și dizajin.

grafica — grafică și dizajin












































































BEOGRAD INTER-CONTINENTAL HOTEL






















































Muslim Mulliqi (1934-1998)

Muslim MULLIQI u lind në vitin 1934 në Gjakovë. Akademinë e Arteve Figurative e kreu në Beograd te profesor Zora Petroviq. Studimet pasuniversitare i kreu te i njëjti profesor në vitin 1961. Ka qenë anëtar i SHAFK që nga themelimi. Është njëri prej themeluesve dhe Dekan i parë i Akademisë së Arteve në Prishtinë, ndërsa anëtarë i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës është prej vitit 1980. Vdiq në vitin 1998.

Muslim MULLIQI was born in 1934 in Gjakova. He finished The Academy of Fine Arts in Belgrade with Professor Zora Petrovic. He also finished his Postgraduate studies with the same Professor in 1961. He was a member of SHAFK since it's foundation. He is one of the founders and the first Dean of the Academy of Arts in Prishtina, and a member of the Academy of Sciences and Arts of Kosovo since 1980. He died in 1998.

Ekspozitat individuale

1952 – Pallati i Kulturës,
Gjakovë
1956, 1960, 1965 – Foajeu i
Teatrit Popullor, Prishtinë
1967 – Pallati i Kulturës,
Smederevë
1967 – Galeria e Shtëpisë së
APJ-së, Tuzëll, Rjekë, Pulë
1969 – Foajeu i Teatrit Popullor,
Prishtinë
1970 – Salloni i Vogël Figurativ,
Novi Sad
1973 – Galeria e APJ-së,
Beograd
1974 – Galeria Gjuro Salaj,
Beograd
1975 – Galeria Heleoart, Romë
(Itali)
1979 – Galeria e Arteve,
Prishtinë
1980 – Klubi i Artistëve,
Prishtinë; Galeria
Bashkëkohore,
Podgoricë
1981 – Pallati i Kulturës, Banja
Llukë
1982, 1991 – Galeria Forum,
Zagreb
1984 – Galeria e Vogël, Lubjanë
1986 – Galeria e Shtëpisë së
APJ-së, Beograd
1987 – Galeria Moderne, Budvë
1989, 1990 – Galeria e KO,
Grozhnjan; Galeria Kombëtare
e Arteve, Tiranë
1996 – Galeria Europa, Pejë,
Galeria Roma, Prishtinë.

Ekspozitat kolektive më me rëndësi

1967 – Trienali i Artit Figurativ
Jugosllav, Beograd
1968 – Memoriali i V Nadezhda
Petroviq, Çaçak
1970 – Artet Figurative të
Kosovës, Sarajevë, Pesë
Piktorë nga Kosova,
Beograd
1971-1979, 1980, 1985, 1988 –
Arti Figurativ i Kosovës,
Katovicë (Poloni), Budapest
(Hungari), Kozencë (Itali),
Hanover
(Gjermani), Kajro (Egjipt),
Frankfurt (Gjermani), Helsinki
(Finlandë), Oslo (Norvegji), Nju
Delhi (Indi), Keln (Gjermani),
Duisburg, Shtutgard (Gjermani),
Palermo (Itali), Paris (Francë);
1972 – Manifestimi i Artit
Jugosllav, Tingujt e Mermertë,
Arangjellovc; Artistët
Figurativë të Kosovës, Banja
Llukë;
1973 – Ekspozita e Sallonit të
Artit Bashkëkohor, Beograd;
Pesë Piktorë
nga Kosova, Beograd;
1973 – 1975, 1978 – 1980, 1982,
1985, 1987, 1991, 1992 – Salloni
Pranveror i Kosovës, Prishtinë;
Dhjetë Artistë nga Kosova,
Beograd;
1974 – Ekspozita e Artit
Figurativ të Kosovës; Nish;
Çaste të Artit Bashkëkohor
Jugosllav, Sombor; Vjeshta XIV
Figurative, Sombor;
1975-1978 – Arti Bashkëkohor
i Kosovës, Shkup, Sarajevë,
Zagreb;

1979, 1981, 1983, 1985, 1987 –
Bienali i Vizatimit, Prishtinë;
Çaste Pikturale Jugosllave,
Beograd;
1980, 1981 – Arti Bashkëkohor i
Kosovës, Beograd, Zagreb;
1979 – Ekspozita
Ndërkombëtare, Slovenj
Gradec;
1981 – Ekspozita e LSHAFJ,
Shkup;
1983 – Vjeshta XXXIII
Figurative, Sombor; Salloni XV
Vjeshtor, Banja Llukë;
1983, 1987 – Arti Bashkëkohor
i Kosovës, Beograd, Prishtinë,
Dubrovnik;
1986 – Galeria mbi Atlantik,
Toronto (Kanada);
1987 – Ekspozita
Ndërkombëtare në Can-sur-
Mer (Francë);
1988 – Trienali i VI i Artit
Jugosllav, Beograd; Artistët
Figurativë Bashkëkohor
Jugosllav, Beograd; Dhjetë
Artistë Kosovarë, Augsburg
(Gjermani);
1990 – Bienali III Ndërkombëtar,
Kajro (Egjipt);
1992 – Zagreb; 1980,
1981 – Arti Bashkëkohor i
Kosovës, Beograd; Ekspozita
Mbarëshqiptare, Tiranë.

Shpërblimet

1954 – Çmimi i Dhjetorit të

Kosovës, Prishtinë;

1965 – Çmimi i Nëntorit të

Qytetit të Prishtinës, Prishtinë;

1968 – Çmimi Blerës i

Akademisë së Arteve të

Beogradit në

Sallonin e Tetorit, Beograd;

1969 – Çmimi i SHAFK,

Prishtinë;

1973 – Çmimi Blerës i Sallonit

të Cetinjes, Cetinje;

1974 – Çmimi i Sallonit

Pranveror të Kosovës,

Prishtinë;

1975 – Çmimi Blerës në Sallonin

Pranveror të Kosovës,

Prishtinë;

1990 – Çmimi i Parë për Pikturë

në Sallonin Pranveror të

Kosovës, Prishtinë.

Solo Exhibitions

1952 - Cultural Center, Gjakova,
1956, 1960, 1965 – Hall of the
National Theater, Prishtina;
1967 - Cultural Center,
Smederevo;
1967 - JNA (Yugoslav National
Army) Gallery, Tuzla, Rijeka,
Pula,
1969 –Hall of the National
Theater, Prishtina;
1970 - Small Figurative Salon,
Novi Sad;
1973 - JNA Gallery, Belgrade;
1974 - GjuroSalaj Gallery,
Belgrade;
1975 - Heleoart Gallery, Rome
(Italy);
1979 - Art Gallery, Prishtina;
1980 - The Artists' Club,
Prishtina; Contemporary
Gallery, Podgorica;
1981 – Cultural Center, Banja
Luka;
1982, 1991 – Forum Gallery,
Zagreb;
1984 - Small Gallery, Ljubljana;
1986 - JNA Gallery, Belgrade;
1987 –Modern Gallery, Budva;
1989, 1990 –KO Gallery,
Grozhnjan; National Art
Gallery, Tirana;
1996- Europa Gallery, Peja,
Roma Gallery, Prishtina.

Collective Exhibitions (the most important ones)

1967 –Yugoslav Triennial of
Figurative Art, Belgrade;
1968 – Memorial of V
Nadezhda Petrovic, Cacak;
1970 - Figurative arts of Kosovo,
Sarajevo; Five Painters from
Kosovo,

Belgrade;
1971-1979, 1980, 1985, 1988
- Figurative Art of Kosovo,
Katowice (Poland), Budapest
(Hungary), Cosenza (Italy),
Hanover (Germany), Cairo
(Egypt), Frankfurt (Germany),
Helsinki (Finland), Oslo
(Norway), New Delhi (India),
Cologne (Germany), Duisburg,
Stuttgart (Germany), Palermo
(Italy), Paris (France);
1972 - The Manifestation
of Yugoslav Art, Marble
Sound, Arandjelovac; Kosovo
Figurative Artists, Banja Luka;
1973 - Contemporary Art
Salon Exhibition, Belgrade;
Five Painters from Kosovo,
Belgrade; 1973 - 1975, 1978 -
1980, 1982, 1985, 1987, 1991,
1992 - Spring Sale of Kosovo,
Prishtina; ten Artists from
Kosovo, Belgrade;
1974 - Exhibition of Figurative
Art of Kosovo; Nis; Moments
of Contemporary Yugoslav
Art, Sombor; XIV Figurative
Autumn, Sombor;
1975-1978 - Contemporary Art
of Kosovo, Skopje, Sarajevo,
Zagreb;
1979, 1981, 1983, 1985, 1987 -
Drawing Biennial, Prishtina;
Yugoslav Photographic Days,
Belgrade;
1980, 1981- Contemporary Art
of Kosovo, Belgrade, Zagreb;
1979 - International Exhibition,
Slovenj Gradec;
1981 - LSHAFJ Exhibition,
Skopje;
1983 - XXXIII Figurative
Autumn, Sombor; XV Autumn
Salon, Banja Luka;
1983, 1987 - Contemporary Art

Kosovo, Belgrade, Prishtina,
Dubrovnik;
1986 - Atlantic Gallery, Toronto
(Canada);
1987 - International Exhibition
in Can-sur-Mer (France);
1988 - VI Triennial of Yugoslav
Art, Belgrade; Contemporary
Figurative Artists
Yugoslavia, Belgrade; Ten
Kosovar Artists, Augsburg
(Germany);
1990 - III International Biennial,
Cairo (Egypt);
1992 - Zagreb; 1980, 1981 -
Contemporary Art of Kosovo,
Belgrade; The Albanian
Exhibition, Tirana.

Rewards

1954 - December Prize of
Kosovo, Prishtina;
1965 - November Prize of the
City of Pristina, Pristina;
1968 - Buyer Prize of Belgrade
Academy of Arts in
October Salon, Belgrade;
1969 - Price of SHAFK, Pristina;
1973 - Buyer Prize of Cetinje
Salon, Cetinje;
1974 - Kosova Spring Award,
Prishtina;
1975 - Buyer Prize at the
Kosovo Spring award,
Pristina;
1990 - First Prize for Painting
at the Kosova Spring Salon,
Prishtina.

Faqe / Page 26: 84 x 60 cm
Faqe / Page 27: 84 x 60 cm
Faqe / Page 28: 70 x 70 cm
Faqe / Page 29: 50 x 45 cm
Faqe / Page 30: 60 x 40 cm
Faqe / Page 31: 58x 40 cm
Faqe / Page 32: 67 x 57 cm
Faqe / Page 33: 90 x 67 cm
Faqe / Page 34: 100 x 70 cm
Faqe / Page 35: 59 x 42 cm
Faqe / Page 36: 100 x 70 cm
Faqe / Page 37: 100 x 70 cm
Faqe / Page 38: 100 x 70 cm
Faqe / Page 39: 21 x 29 cm
Faqe / Page 40: 14 x 23 cm
Faqe / Page 41: 10 x 18 cm
Faqe / Page 42: 14 x 18 cm
Faqe / Page 43: 14 x 18 cm
Faqe / Page 44: 21 x 14 cm
Faqe / Page 45: 24 x 16 cm
Faqe / Page 46: 52 x 40 cm
Faqe / Page 47: 30 x 20 cm
Faqe / Page 48: 29 x 21 cm
Faqe / Page 49: 47 x 32 cm
Faqe / Page 50: 52 x 42 cm
Faqe / Page 51: 53 x 32 cm
Faqe / Page 52: 54 x 36 cm
Faqe / Page 53: 60 x 42 cm
Faqe / Page 54: 52 x 39 cm
Faqe / Page 55: 32 x 24 cm
Faqe / Page 56: 20 x 18 cm
Faqe / Page 57: 13 x 9 cm
Faqe / Page 58: 25 x 29 cm
Faqe / Page 59: 56 x 44 cm
Faqe / Page 60: 17 x 12 cm
Faqe / Page 61: 15 x 10 cm
Faqe / Page 62: 44 x 44 cm
Faqe / Page 63: 40 x 52 cm
Faqe / Page 64: 60 x 48 cm
Faqe / Page 65: 16 x 12 cm
Faqe / Page 66: 48 x 46 cm
Faqe / Page 67: 59 x 42 cm
Faqe / Page 68: 50 x 40 cm

Faqe / Page 69: 47 x 42 cm
Faqe / Page 70: 42 x 42 cm
Faqe / Page 71: 50 x 35 cm
Faqe / Page 72: 47 x 41 cm
Faqe / Page 73: 45 x 43 cm
Faqe / Page 74: 52 x 30 cm
Faqe / Page 75: 57 x 38 cm
Faqe / Page 76: 50 x 40 cm
Faqe / Page 77: 29 x 21 cm
Faqe / Page 78: 29 x 29 cm
Faqe / Page 79: 46 x 33 cm
Faqe / Page 80: 44 x 40 cm
Faqe / Page 81: 24 x 14 cm
Faqe / Page 82: 29 x 21 cm
Faqe / Page 83: 35 x 29 cm
Faqe / Page 84: 50 x 70 cm
Faqe / Page 85: 60 x 42 cm
Faqe / Page 86: 26 x 30 cm
Faqe / Page 87: 21 x 29 cm
Faqe / Page 88: 21 x 29 cm
Faqe / Page 89: 25 x 35 cm
Faqe / Page 90: 21 x 29 cm
Faqe / Page 91: 14 x 23 cm
Faqe / Page 92: 15 x 24 cm
Faqe / Page 93: 37 x 29 cm
Faqe / Page 94: 50 x 70 cm
Faqe / Page 95: 60 x 42 cm
Faqe / Page 96: 70 x 50 cm
Faqe / Page 97: 56 x 47 cm
Faqe / Page 98: 21 x 14 cm
Faqe / Page 99: 21 x 14 cm
Faqe / Page 100: 32 x 24 cm
Faqe / Page 101: 31 x 23 cm
Faqe / Page 102: 34 x 24 cm
Faqe / Page 103: 36 x 20 cm
Faqe / Page 104: 58 x 41 cm
Faqe / Page 105: 32 x 25 cm
Faqe / Page 106: 40 x 36 cm
Faqe / Page 107: 66 x 42 cm
Faqe / Page 108: 56 x 33 cm
Faqe / Page 109: 50 x 40 cm
Faqe / Page 110: 52 x 40 cm
Faqe / Page 111: 32 x 45 cm

Faqe / Page 112: 46 x 39 cm
Faqe / Page 113: 53 x 27 cm
Faqe / Page 114: 23 x 14 cm
Faqe / Page 115: 21 x 15 cm
Faqe / Page 116: 15 x 23 cm
Faqe / Page 117: 24 x 33 cm
Faqe / Page 118: 35 x 25 cm
Faqe / Page 119: 39 x 26 cm
Faqe / Page 120: 15 x 23 cm
Faqe / Page 121: 24 x 34 cm
Faqe / Page 122: 15 x 10 cm
Faqe / Page 123: 100 x 70 cm
Faqe / Page 124: 14 x 21 cm
Faqe / Page 125: 18 x 20 cm
Faqe / Page 126: 20 x 16 cm
Faqe / Page 127: 19 x 14 cm
Faqe / Page 128: 24 x 32 cm
Faqe / Page 129: 32 x 27 cm
Faqe / Page 130: 50 x 44 cm
Faqe / Page 131: 16 x 12 cm
Faqe / Page 132: 53 x 39 cm
Faqe / Page 133: 16 x 10 cm
Faqe / Page 134: 54 x 47 cm
Faqe / Page 135: 21 x 29 cm
Faqe / Page 136: 55 x 50 cm
Faqe / Page 137: 45 x 39 cm
Faqe / Page 138: 55 x 50 cm
Faqe / Page 139: 77 x 56 cm
Faqe / Page 140: 76 x 56 cm
Faqe / Page 141: 50 x 70 cm
Faqe / Page 142: 52 x 40 cm
Faqe / Page 143: 32 x 24 cm
Faqe / Page 144: 65 x 48 cm
Faqe / Page 145: 75 x 53 cm





u. m. m. 75

